



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 839/5 Prot.

Tiranë, më 06/11/2015

REKOMANDIM

Nr. 37, datë 06/11/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë*".

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 183, datë 23/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë subjektit "*Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë*", me objekt:

- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme*" i ndryshuar.
- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Subjekti "*Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tiranë*", është institucion publik në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor. Ky subjekt ushtron aktivitetin e tij mbështetur në Ligjin nr. 8378 datë 22/07/1998 "*Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë*", Ligjin nr. 8308 datë 18/03/1998 "*Për Transportet Publike*", ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë fushën e transportit.

Gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, është konstatuar se ambientet në të cilat u shërbehet qytetarëve dhe ambientet e jashtme të godinës, janë të mbikëqyrura me sistem video-vëzhgimi (më poshtë sistem CCTV). Sistemi CCTV është i përbërë në tërësi nga kamera dhe pajisje video regjistruese.

Me provat e administruara gjatë këtij hetimi administrativ, konkludohet se sistemi CCTV i cili mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës, është instaluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe administrohet prej Sektorit të Rrjetit

Informatik dhe Sigurisë së të Dhënave pranë kësaj drejtorie. Të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim riparimin, ndryshimin e këndit të vëzhgimit apo kontrollin fizik të kamerave dhe sistemit NVR bëhet nga/me autorizimin e qendrës.

Bazuar në provat e administruara nëpërmjet fotografimit të ambienteve të mbikëqyrra nëpërmjet sistemit CCTV, konkludohet se kontrolluesi realizon informimin e subjekteve të të dhënave duke përdorur tabelat informuese sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në cilësinë e kontrolluesit, e cila vetëm apo së bashku me të tjerë përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga verifikimi paraprak në Regjistrin Elektronik të njoftimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, rezultoi se kontrolluesi e ka plotësuar detyrimin për njoftim. Nga verifikimi i "Formularit të Njoftimit", konkludohet se kontrolluesi duhet të realizojë përditësimin e formularit të njoftimit duke përfshirë edhe veprimtarinë e Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është thirrur kontrolluesi "Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor" për tu paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme.

Në përfundim të seancës dëgjimore, u konkludua se:

- Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në cilësinë e "kontrolluesit", është **i vetmi përgjegjës** dhe **i vetmi kontrollues** për të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor në Republikën e Shqipërisë;
- Formulari i Njoftimit nuk është plotësuar në përputhje me nenin 22 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/pika 1/"a/1" të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ:

1. Të zbatohet Udhëzimi nr. 3 datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Të realizohet përditësimi i "Formularit të Njoftimit", pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në cilësinë e "kontrolluesit", të marrë atributet si *i vetmi kontrollues përgjegjës*, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, për të gjitha Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor në Republikën e Shqipërisë.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryhet plotësimi i këtyre detyrimeve brenda një afati 30 ditor, nga momenti i njoftimit të këtij Rekomandimi dhe pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më, 06/11/2015

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI
